



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike

Tiranë më 04.11.2024

Dokument parlamentar
(Komision për dhënie mendimi)

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2026”
(shqyrtimi në parim)

I. Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, në mbledhjen e datës 10 nëntor, shqyrtoi dhe miratoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2026”, i cili është propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Për shqyrtimin e këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike caktoi relator z. Ermal Pacaj.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin ishin z. Petrit Malaj, Ministër i Financave dhe përfaqësues të tjerë të ministrisë.

Bazuar në vendimin e Konferencës së Kryetarëve, Komisioni për Çështjet Ligjore, dhe Administratën Publike e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

II. Baza ligjore e projektligjit, vlerësimi kushtetues dhe procedural

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2026” është propozuar nga Këshilli i Ministrave, në bazë të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky projektligj i nënshtrohet një procedure të posaçme shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

Projektligji parashikon tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore si dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve) për vitin buxhetor 2026.

III. Objektivat e përgjithshme të buxhetit 2026

Projektbuxheti për vitin 2026 është hartuar në vazhden e objektivit strategjik të Qeverisë për të afruar Shqipërinë me standardet e Bashkimit Evropian, si në aspektin ekonomik, social, institucional, ashtu edhe në atë të qeverisjes. Në këtë drejtim, ai mbështetet tek Plani i Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor, i cili paraqet një instrument të rëndësishëm për nxitjen e konvergjencës ekonomike me vendet anëtare të unionit dhe përgatitjen e vendit për të realizuar synimin afatgjatë të anëtarësimit në BE deri në vitin 2030. Në të njëjtën kohë, projektbuxheti vazhdon zbatimin e politikës së konsolidimit fiskal, e cila synon ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe sigurimin e një trajektoreje të qartë zbritëse të borxhit publik në periudhën afatmesme 2026–2028.

Në planin ekonomik, rritja reale e PBB-së pritet të jetë rreth 3.9% në vitin 2025, e nxitur veçanërisht nga turizmi, performanca e sektorit të shërbimeve dhe intensifikimi i aktivitetit të ndërtimit. Për periudhën 2026–2028, ekonomia parashikohet të vijojë trendin pozitiv me një mesatare vjetore rritjeje prej rreth 4%, e mbështetur nga forca e kërkesës së brendshme, zgjerimi i sektorëve strategjikë dhe një përmirësim gradual i kushteve ekonomike ndërkombëtare, sidomos në hapësirën e Bashkimit Evropian, që përbën partnerin tonë kryesor tregtar. Rritja do të vijojë të mbështetet kryesisht nga konsumi privat, i cili ushqehet nga rritja e të ardhurave, përmirësimi i tregut të punës, rritja e pagave dhe stabilizimi i inflacionit në nivele të synuara.

Në aspektin fiskal, deficitin buxhetor për vitin 2026 projektohet në 2.3% të PBB-së, duke ruajtur të njëjtin nivel me pritshmërinë për vitin 2025. Borxhi publik do të vijojë trajektoren zbritëse, duke rënë në 54.1% të PBB në vitin 2025 dhe më tej në 53.6% në vitin 2026, ndërsa sipas skenarit bazë, ai parashikohet të bjerë në 51.0% në vitin 2028 dhe të arrijë rreth 46.4% të PBB-së në vitin 2031, duke konsoliduar qëndrueshmërinë fiskale në afatgjatë.

Të ardhurat buxhetore të vitit 2026 pritet të arrijnë në 823.1 miliardë lekë ose 29.6% të PBB-së, nga të cilat të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat parashikohen të arrijnë në vlerën 531 miliardë lekë, duke reflektuar një rritje prej 31.5 miliardë lekë ose me rritje vjetore prej 6.3%, ndërsa të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore pritet të jenë rreth 197 miliardë lekë, me një rritje prej 20.2 miliardë lekë ose 11.4% krahasuar me vitin 2025. Parashikimet e të ardhurave mbështeten në rritjen e pritshme ekonomike, inflacionin e kontrolluar, përmirësimin e administrimit fiskal dhe reduktimin e informalitetit.

Ndërkohë, shpenzimet buxhetore programohen në 886.8 miliardë lekë ose rreth 31.9% të PBB-së, duke reflektuar masat për rritjen graduale të pensioneve, përfshirë rritjen e pensionit minimal në 200 euro në muaj dhe atij mesatar në 400 euro në muaj, si dhe mbulimin e plotë të kostos së pagës minimale prej 50,000 lekësh nga 1 janari 2026, e cila pritet të rritet në 60,000 lekë në vitin 2028. Administrata publike do të përfitojë gjithashtu indeksimin 2.5% të pagave, duke ruajtur fuqinë blerëse të punonjësve.

Projektbuxheti për vitin 2026 programon shpenzimet publike si më poshtë:

- Shpenzimet totale për pagat në administratën publike në nivel qendror, për rreth 87,112 punonjës, planifikohen në nivelin 140.1 miliardë lekë, duke përfshirë efektin e indeksimit të pagave dhe rritjen e pagës minimale. Kjo paketë rritjeje sjell një kosto shtesë totale prej rreth 10 miliardë lekë.
- Shpenzimet për interesa të borxhit publik parashikohen në 64.2 miliardë lekë. Brenda kësaj shume është përfshirë edhe një rezervë prej 6.3 miliardë lekë për të përballuar risqet që mund të vijnë nga luhatjet e normave të interesit dhe kursit të këmbimit.
- Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore parashikohen në 81 miliardë lekë, ku përfshihet financimi i prioritetëve si: skema e fermerëve, mirëmbajtja e rrugëve kombëtare, siguria kibernetike dhe mirëmbajtja e sistemeve IT, programet e nxitjes së punësimit, mbështetja e politikave të zhvillimit ekonomik, si dhe programet për arsimin dhe sportin.
- Shpenzimet e buxhetit vendor janë planifikuar në 97.7 miliardë lekë, duke shënuar një rritje rreth 9% krahasuar me vitin 2025, dhe duke përfaqësuar 3.52% të PBB-së. Në total, granti nga buxheti i shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore arrin në 47.3 miliardë lekë, nga të cilat:
 - ✓ 27.8 miliardë lekë transfertë e pakushtëzuar,
 - ✓ 13.8 miliardë lekë transfertë sektoriale për funksionet e reja,
 - ✓ 200 milionë lekë grant performance,
 - ✓ 5.5 miliardë lekë transfertë sektoriale për rritjen e pagave.
- Shpenzimet e fondeve speciale programohen në total 286.6 miliardë lekë, ku:
 - ✓ Skema e Sigurimeve Shoqërore parashikohet në 204.1 miliardë lekë (përfshirë 1.65 miliardë lekë për indeksim pensioni dhe 10 miliardë lekë për bonus mujor për pensionistët),
 - ✓ Skema e Kujdesit Shëndetësor në 67.3 miliardë lekë, përfshirë shtesën prej 1.5 miliardë lekë për rimbursimin e barnave onkologjike dhe shërbimin spitalor.
 - ✓ Fondi i kompensimit të ish-pronarëve parashikohet në 3.5 miliardë lekë.
- Shpenzimet të tjera sociale parashikohen në 28.7 miliard lekë, përkatësisht:
 - ✓ Pagesa e papunësisë në nivelin 1 miliardë lekë,
 - ✓ Ndihma ekonomike dhe aftësia e kufizuar në rreth 23.9 miliardë lekë,
 - ✓ Kompensimi i ish-të përndjekurve në nivelin 1.5 miliardë lekë.
 - ✓ Bonusi i lindjeve në nivelin 2.3 miliardë lekë.

- Shpenzimet për subvencione planifikohen në 2.45 miliardë lekë, me rritje vjetore prej 500, të cilat orientohen drejt skemave të nxitjes së punësimit, mbështetjes së sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, si dhe financimit të veprimtarisë hekurudhore dhe shërbimeve qeveritare.

Niveli i Fondi rezervë për vitin 2026 planifikohet në 2.5 miliardë lekë, në rreth 0.1% e PBB.

Qeveria synon të ruajë një nivel të lartë të investimeve publike, me një mesatare prej 6.5% të PBB-së gjatë 2026–2028. Këto investime do të përqendrohen në projekte strategjike kombëtare, veçanërisht në fushat e dixhitalizimit të administratës publike, përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe energjetike, sigurisë kombëtare, shëndetësisë, arsimit, bujqësisë dhe zhvillimit rural, në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021–2030 dhe me prioritetet e Planit të Rritjes së BE-së. Për vitin 2026, investimet publike parashikohen në 179.6 miliardë lekë, duke përfshirë 5 miliardë lekë fond rindërtimi dhe 6.8 miliardë lekë financime të pritshme nga Plani i Rritjes me BE.

IV. Realizimi i Reformës në Drejtësi

Aspekt tjetër i rëndësishëm për tu përmendur është mbështetja financiare e reformës në drejtësi, e cila ka qenë një ndër prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare dhe që tanimë ka dhënë frytet e saj, duke rritur besimin e publikut që po krijohet një sistem drejtësie i besueshëm, i drejtë, të pavarur, profesional.

Për reformën në drejtësi dhe institucionet e ngritura për të realizuar atë, që prej vitit 2016 qeveria shqiptare ka shpenzuar rreth 73 miliardë lekë, një reformë shumë e rëndësishme, e ka ndihmuar në mënyrë të padiskutueshme edhe zhvillimin ekonomik afatmesëm. Po të llogarisim dhe fondet e akorduara për Ministrinë e Drejtësisë, që nga viti 2016 për komponentin e drejtësisë është shpenzuar mbi 175 miliardë lekë.

Ndërsa fondet e parashikuara për të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë në projektbuxhetin e vitit 2026 planifikohet të arrijnë në pothuajse 13.8 miliardë lekë, me një rritje 1.49 miliardë lekë ose prej 12%, krahasuar me fondet e akorduara për to gjatë vitit 2025. Gjithashtu, numri total i punonjësve të këtyre institucioneve planifikohet të jetë 3653 punonjësish, me rritje të personelit prej 122 punonjës shtesë.

Rritjen më të madhe të shpenzimeve buxhetore në krahasim me fondet e akorduara për vitin aktual, për institucionet e drejtësisë e ka KLGJ me një rritje me 1132 milion lekë ose 20% më shumë, SPAK me një rritje me 233 milion lekë ose 12.4% më shumë, Prokuroria e Përgjithshme 205 milion lekë ose 6.4% më shumë dhe KLP me pothuajse 17 milion lekë ose 8% më shumë.

Nuk duhet të harrojmë se në vitin 2026, është përcaktuar gjithashtu dhe mbyllja e institucionit të tretë të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve, Komisionit të Posaçëm të Apelit.

Si rrjedhojë në nenin 12, pika 1, paragrafi i dytë i projektbuxhetit është parashikuar që për vitin 2026, për një periudhë që nuk do të zgjasë më shumë se gjashtëmujori i dytë, me qëllim përmbylljen e procesit të mbylljes së veprimtarisë administrative të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, një pjesë e personelit administrativ të këtij institucioni, sipas vendimit të Kuvendit, së bashku me fondet buxhetore përkatëse në dispozicion të tij, do të kalojnë në programin buxhetor “Veprimtaria gjyqësore kushtetuese” në kuadër të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu, rritje të shpenzimeve buxhetore është planifikuar disa institucione të tjera të pavarura të cilat raportojnë në komisionin tonë. Kështu në projektbuxhet është parashikuar rritja e shpenzimeve buxhetore të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil me 3 milion lekë dhe e Komisionit të Prokurimit Publik me 24 milion lekë.

Në krahasim me vitin 2025 fondet e planifikuara për Ministrinë së Drejtësisë kanë pësuar rritje, ku parashikohet një buxhet total prej afërsisht 14.96 miliard lekë, ose 33 milion lek më shumë. Kurse numri i përgjithshëm i punonjësve është rritur me 35 punonjës më shumë duke u planifikuar që për vitin e ardhshëm të arrijë në 5391 punonjës.

Ministria e Drejtësisë në përputhje me fushën e vet të veprimtarisë ka planifikuar një sërë objektivash për tu përmbushur gjatë periudhës afatmesme 2026-2028, të cilat ndër të tjera përfshijnë:

- Sigurimi i mbështetjes gjithëpërfshirëse ligjore dhe rehabilituese, duke përfshirë këshillimin dhe përfaqësimin falas për individët që plotësojnë kushtet ligjore për ndihmën juridike (rreth 2,000 akte), si dhe ndihmën juridike për rreth 3000 gra dhe vajza në nevojë.
- Për të dënuarit, synohet të mbahen kushte të përshtatshme për 5500 të dënuar burra, 86 të dënuara gra dhe 36 të dënuar të mitur, duke përfshirë shërbimin shëndetësor për 438 të dënuar me probleme shëndetësore, dhe të zbatohen programe rehabilitimi dhe ri-integrimi në shoqëri për 360 të dënuar burra, 2 të dënuara gra dhe 6 të dënuar të mitur, sipas standardeve europiane.
- Normat e recidivitit pritet të mbeten të qëndrueshme gjatë periudhës: 18% për burrat, dhe 1% për gratë dhe të miturit. Po ashtu, ruhet një trend i qëndrueshëm për punësimin pas lirimit, duke synuar 11% të të dënuarve që të punësohen.
- Në sistemin penitenciar, synohet përmirësimi i kushteve dhe ulja e mbipopullimit, ku 50% e IEVP-ve do të ofrojnë standarde të plota sigurie, trajtimi dhe rehabilitimi deri në fund të vitit 2028. Shërbimi i provës do të mbikëqyret për efektivitetin e tij, duke përfshirë 7000–9000 burra, 800–850 gra dhe 220–250 të mitur çdo vit.
- Skema e shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit synon të rritë vendimet e kompensimit nga 842 në vitin 2026 në 2343 vendime në vitin 2028. Po ashtu, synohet të rritet numri i titujve të ekzekutuara brenda afateve ligjore, nga 11708 në vitin 2026, në 12953 në vitin 2028.
- Për fëmijët, do të garantohet interesi më i lartë përmes vendosjes së tyre në familje të përhershme, të përshtatura me nevojat specifike të secilit, duke synuar që 100% e birësimeve të rezultojnë me vendosje të suksesshme dhe të qëndrueshme.

Disa institucione të tjera kanë pasur fonde të reduktuara në krahasim me vitin aktual. Megjithatë, projeksionet e Ministrisë së Financave janë bërë duke mbajtur parasysh dhe realizimin e buxhetit aktual. Ku referuar të dhënave të raportuara për 10 muajt e parë të vitit rezulton se niveli i zbatimit të buxhetit është vetëm 62.4%, me nivele të larta mosrealizimi sidomos në zërin e investimeve, ku për institucionet e pavarura kanë një mosrealizim të këtij zëri që varion nga 85-95%.

V. Diskutime në Komision

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2026” u prezantua në Komision nga Ministri i Financave. Në fjalën e tij Ministri bëri një përmbledhje të parametrave të përgjithshëm të ekonomisë shqiptare, masave të projektuara për vitin 2026 nga Qeveria për qytetarët, si dhe një panoramë të përgjithshme të drejtimeve kryesore ku do të fokusohet buxheti vitin e ardhshëm.

Ministri theksoi faktin se në këtë projektbuxhet, një vëmendje e veçantë i është kushtuar financimit të Planit të Rritjes së Bashkimit European (BE) për Ballkanin Perëndimor, si një instrument i rëndësishëm për përshejtimin e konvergencës ekonomike sociale të vendit tonë me vendet e BE.

Relatori i këtij projektligji z. Ermal Pacaj pasi bëri një ekspozë të përgjithshme të projektligjit për sa i takon përmbushjes së objektivave madhorë të Qeverisë dhe sigurimit të stabilitetit të financave publike, vlerësoi se zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore janë planifikuar në mënyrë rigorozë dhe realiste.

Ai theksoi se projektbuxheti për vitin 2026 është një dokument strategjik që shkon përtej aspektit financiar, duke synuar forcimin e shtetit të së drejtës, konsolidimin institucional dhe përmirësimin e shërbimeve publike për qytetarët.

Në mënyrë të veçantë, relatori nënvizoi se komponenti i drejtësisë zë një vend qendror në këtë projektbuxhet, me rritje të ndjeshme të fondeve për institucionet e sistemit gjyqësor, përfshirë KLGJ, SPAK, Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë. Ai theksoi se ky financim siguron vijimësinë e Reformës në Drejtësi, forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe përmbushjen e detyrimeve që lidhen me Kapitullin 23 të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Anëtarët e Komisionit i drejtuan pyetje të ndryshme si dhe kërkuan informacione të hollësishme nga Ministri i Financave lidhur me parashikimet në buxhetin e vitit të ardhëm për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë dhe ish pronarëve, rritjen e pensioneve, indeksimin e pagave në administratën publike dhe fondet e akorduara në buxhetin e 2026 për njësitë e qeverisjes vendore, etj.

Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, në përfundim të diskutimeve vendosi të miratojë në parim projektligjin me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje, duke konstatuar se:

- **Në aspektin ligjor**, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi,
- **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Komisioni, në përputhje me nenet 79 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit dhe afateve të përcaktuara Kalendarin e Kuvendit “Për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2026””, ia paraqet këtë raport Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat.

RELATOR

KRYETAR

Ermal PACAJ

Ulsi MANJA